



ICM  
Institute  
for Crisis  
Management

Здружение на граѓани Институт за Кризон Менаџмент  
Shoqata qytetare Instituti për Menaxhim me Kriza  
Institut for Crisis Management  
IKM IMK ICK

Бр. Nr. No. 03-1/3



KOLEGJI - COLLEGE  
**BIZNESI**  
Prishtinë

**KOLEGJI "BIZNESI"**

Nr. 107/20 Data 09.11.2020  
PRISHTINË

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

në mes të:

**KOLEGJIT "BIZNESI" DHE**

dhe

**INSTITUTI PËR MENAXHIM ME KRIZA-IMK SHKUP**

Në frymën e zhvillimit të një edukimi universitar sa më të afërt me tregun e punës, me datën 09/11/2020 Kolegji Biznesi (më poshtë si "Kolegji"), i përfaqësuar nga **Rektori Prof. Dr. Shyqeri Kabashi** dhe **Instituti për Menaxhim me Kriza – IMK Shkup** (më poshtë si "Instituti"), përfaqësuar nga z. Beqim Kojan, hynë në një marrëveshje bashkëpunimi ndër-institucionale.

### Qëllimi i marrëveshjes

I.

Palët nënshkruese pajtohen që t'i sigurojnë, në mënyrë adekuate aktivitetet në vijim për realizimin e qëllimit nga ky Memorandum bashkëpunimi.

- A. Kolegji, studentë dhe hulumtues të tjerë universitar kanë mundësi të punojnë me ekipet e IMK-së që të realizojnë aktivitete për hulumtim dhe angazhime të politikave në fushën e studimeve mbi paqën dhe konfliktin; diskriminimin, stereotipe të ndarjes dhe dhunës; arsimim ndërkombëtar dhe krahasues; të drejtat e njeriut lidhur me antidiskriminimin dhe arsimin; dhe / ose studime mbi refugjatët dhe shpërnguljen e detyruar.
- B. Në varshmëri nga aftësitë e veçanta dhe interesat e fakultetit të përzgjedhur, studentë dhe hulumtues të tjerë universitar, projekti hulumtues mund të përmbajë aktivitetet në vijim:
  - Të shkruarit raporte mbi politika dhe hulumtime, raporte të shkurtra ose shkrime për blogje që do të shpallen në ueb faqen e universitetit;
  - Prezencë dhe pjesëmarrje në takimet e nivelit të lartë në ministri, organizata ndërkombëtare, institucione akademike dhe sintetizim i raporteve për vëzhgim;
  - Prezencë dhe pjesëmarrje në takimet e ekipit dhe grupit punues të universitetit;
  - Aktivitete komunikimi në terren;
  - Puna e fushatës së universitetit për lobim për marrëveshje ndërkombëtare dhe zhvillim të videove dhe materialeve të tjera për përfaqësim, sidomos për të rinjtë;
  - Zhvillim i mjeteve inovative për edukim dhe për informim.
- C. Universiteti dhe instituti do të punojnë së bashku për të zgjedhur fakultetin përkatës, studentë dhe hulumtues të tjerë universitarë për angazhime në kryerjen e obligimeve nga kjo marrëveshje.

## Detyrat e punës

II.

- A. Kur përfshihen në mënyrë aktive në format e bashkëpunimit të përcaktuara në këtë Memorandum bashkëpunimi, të gjitha komunikimet ndërmjet universitetit dhe Institutit duhet të jenë në kohë dhe t'i përmbahen afateve të brendshme dhe standardeve për të cilat janë dakorduar dy palët.
- B. Të gjitha dërgesat dhe informacionet e nevojshme për ekzekutimin e formave të bashkëpunimit të përcaktuara në këtë Memorandum për shkëmbim, vihen në dispozicion në intervale ose sipas një orari të dakorduar nga të dy palët.

## Kodi i sjelljes

III.

Universiteti dhe instituti kërkojnë studentë dhe hulumtues universitar të suksesëshëm që do të ndjekin kodin e rreptë të sjelljes. Plagjiatura, referimi joadekuat ose mungesa e profesionalizmit nuk do të tolerohet dhe do të rezultojë me shkarkim të menjëhershëm.

## Pronësia intelektuale dhe mbrojtja e të dhënave

IV.

Çdo material i prodhuar, në çfarëdo formë, i shtypur ose elektronik, nga studentë dhe hulumtues të tjerë të universitetit do të jetë pronë intelektuale e universitetit dhe institutit e që duhet të citohen ose pranohen në mënyrë përkatëse.

## Qasja në terren

V.

Instituti do e paraqesë universitetin si një nga partnerët e saj.

## Efekt i marrëveshjes

VI.

Marrëveshja shtrinë efekt që nga dita e nënshkrimit nga palët.

## Ndërprerja apo ndryshimet e marrëveshjes

VI.

Ndryshimet në këtë marrëveshje do të bëhen me pëlqimin e ndërsjellë midis dy palëve. Kohëzgjatja e marrëveshjes është e limituar në 5 vite, ndërsa mund të shkëputet me paralajmërim paraprak prej 30 ditësh nga cilado palë nënshkruese.

Për:

Kolegji Biznesi

Rektori

Prof. Dr. Shmyryri Kabashi



Instituti për menaxhim me kriza  
Direktori



Prishtinë më: 09/11/2020